



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 3311 prot.

3

Elbasan, më 6.7.2018

VENDIM

Nr. 34 date **06.07.2018**

**"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR NDALIMIN E PIRJES SË DUHANIT NË MJEDISJET E UNIVERSITETIT TË ELBASANIT
"ALEKSANDËR XHUVANI"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë, neni 38, gërma "d", Statutit të UE-së, neni 9, gërma "d", Ligjin Nr.9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" i ndryshuar; Ligjin Nr.10 237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", Ligji nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Senati Akademik,


V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores "Për ndalimin e pirjes së duhanit në mjediset e Universitetit të Elbasanit "Aleksander Xhuvani", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Administratori, Drejtoria koordinimit dhe marrëdhënies me jashtë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll Arkivit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Skender TOPI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE
"PËR NDALIMIN E PIRJES SË DUHANIT NË MJEDISËT E UNIVERSITETIT
TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i masave për përdoruesit e produkteve të duhanit; mbrojtjen e punonjësve dhe studentëve nga ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit; ndërgjegjësimin për dëmet që vijnë nga pirja e duhanit si dhe informimin për parandalimin e fillimit të pirjes së duhanit.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në Ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, Ligjin Nr.9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", i ndryshuar; Ligjin Nr.10 237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", Ligji nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Neni 3

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është mbrojtja e shëndetit të punonjësve dhe studentëve në Universitetin e Elbasanit nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit.

Neni 4

Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Mjedis pune" konsiderohet çdo hapësirë e mbyllur, ku punonjësit e UE-së dhe studentët ushtrojnë veprimtarinë dhe detyrat për të cilat janë punësuar, si dhe salla





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" SENATI AKADEMIK

mbledhjesh, leksionesh, korridore, shkallë dhe çdo mjedis tjetër i mbyllur, që frekuentohet gjatë orarit të punës dhe mësimdhënies.

"Produkte duhani" janë produkte të prodhuara, tërësisht apo pjesërisht, nga gjitha e duhanit, si lëndë e parë dhe që përdoren për t'u tymosur, thithur, përtypur ose nuhatur.

"Pirje duhani" është ndezja, thithja dhe mbajtja në dorë e ndezur e çdo produkti duhani që digjet. Pirja e duhanit nënkupton përdorimin e produkteve të duhanit brenda mjediseve të UE-së, duke marrë parasysh që ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të çliruar, krijon pasoja të rënda për shëndetin në mënyrë aktive dhe passive.

"Tavllë duhani/ taketuke cigaresh" është një enë e vogël ku shkundet hiri i produktit të duhanit që po digjet dhe ku lihen bishtat e cigareve.

"Masat parandaluese të duhanpirjes" janë veprimtaritë sistematike, që synojnë të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit të popullsisë, duke zgjatur jetën dhe përmirësuar cilësinë

Neni 5

Fusha e zbatimit

Kjo Rregullore zbatohet për sigurimin dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe studentëve të UE-së, në të gjitha godinat ku e shtrin aktivitetin e tij Universiteti i Elbasanit duke u udhëhequr nga parimi trajtimit të barabartë për marrjen e masave për mbrojtjen e sigurisë e të shëndetit në punë.

Neni 6

Vendosja e tabelave për ndalimin e pirjes së duhanit

Në të gjitha mjediset ku e zhvillon aktivitetin Universiteti i Elbasanit (mjedise pune, salla leksioni, korridore, etj.) nuk lejohet pirja e duhanit dhe vendosen tabela të dukshme dhe të lexueshme "NDALOHET PIRJA E DUHANIT".

Neni 7

E drejta e informimit dhe publikimi i masave parandaluese në faqen zyrtare të internetit të UE-së

Çdo punëmarrës dhe student duhet të informohet për pasojat shëndetësore, natyrën droguese dhe kërcënimin vdekjeprurës të shfaqur nga konsumimi i duhanit. Personeli dhe studentët njoftohen edhe për masat e marra për mbrojtjen e shëndetit të tyre nga ekspozimi ndaj tymit të duhanit me anë të publikimit të mesazheve informuese në faqen zyrtare të UE-së, uniel.edu.al, për ndikimin e duhanit dhe rreziqet nga produktet e tij.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Neni 8

Bashkëpunimi me subjektet private që ushtrojnë aktivitet në mjediset e UE-së

Subjektet private që ushtrojnë aktivitet në mjediset e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" kanë përgjegjësinë për zbatimin me korrektësi të Ligjit nr.9636, datë 06.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", i ndryshuar,

Neni 9

Masat administrative

Shkeljet e dispozitave të përcaktuara në Ligjin Nr.9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

Pirja e duhanit në mjediset e punës në Universitet dënohet me:

- 300.000 (treqind mijë lekë) personi i tatuashëm – Universiteti.
- 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, personi përgjegjës në institucionet publike.
- 5 000 lekë (pesë mijë) lekë, duhanpirësi;

Masa e gjobës parashikohet si dënim më vete dhe jepet nga trupat inspektuese. Ankimi ndaj vendimeve të trupave inspektuese, të përcaktuara në ligj, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ, bëhet ankim në Gjykatën Administrative, brenda afateve të parashikuara në dispozitat ligjore.

Neni 10

Informacion për trupat inspektuese

Administratori i UE-së në kuptim të Ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" i ndryshuar, si përgjegjës kryesor për ndalimin e pirjes së duhanit në mjediset e UE-së, err masa për vendosjen në një vend të dukshëm të listës së trupave inspektuese për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe të studentëve, nga produktet e duhanit dhe të shenjave të dukshme, që tregojnë se pirja e duhanit në këto mjedise është e ndaluar.



KRYETARI

Prof.dr. Skender TOPI